



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
AGJENCIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE UJORE

RAPORT MONITORIMI PËR ZBATIMIN E PROCESIT BUXHETOR

Periudha e Raportimit Janar - Dhjetor 2018

Në zbatim të nenit 65 të Ligjit Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimit Nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (ish Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit) u krijua bazuar në ligjin nr. 111/2012, për “Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i ndryshuar, VKM-së nr.221, datë 26.4.2018 për “Organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”, ku në përbërje të tij përvec stafit të STKKU-se, u shtua edhe stafi i Drejtorisë së Politikave të Burimeve Ujore nga MBZHR si dhe Agjencitë e Baseneve Ujore Drin -Bunë, Ishëm- Erzen, Vjosë, Seman, Shkumbin dhe Mat dhe aktualisht ushtron aktivitetin në grupin 87 në programin buxhetor me kod 01150 “Shërbime të tjera”,

Në përdorimin e fondeve buxhetore jemi mbështetur në parimet e menaxhimit dhe funksionimit të sistemit buxhetor. Shpërndarja e burimeve financiare është bërë në përputhje me objektivat e AMBU-së, duke pasur si synim një përdorim më eficient të këtyre burimeve financiare sipas programimit të bërë për vitin 2018.

Fondet buxhetore të ndryshuara për vitin 2018, për Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore në total janë 60,821 mijë lekë, prej të cilave 50,821 mijë lekë janë shpenzime korente dhe 10,000 mijë lekë për shpenzime kapitale. Këto fonde sipas zërave të strukturës buxhetore paraqiten sipas tabelave të mëposhtme, ku jepen edhe realizimet përkatëse për secilin prej tyre, për periudhën Janar - Dhjetor të vitit 2018.


I. Shpenzime korente

SHPENZIMET KORENTE JANAR - DHJETOR 2018

Entite ti Qeveri sjes	Minis tria e Linjes	Kodi I Institucio nit	Kapit ulli	Programi	Llogaria Ekonomike	Buxheti vjetor 2018 I rishikuar	Shpenzimet Faktike Janar- Dhjetor 2018	Diferenca	% realizimit
1	2	3	4	5	6	8		12	13
001	87	1087016	01	01150	6000000	38,100,000	24,025,031	14,074,969	63
001	87	1087016	01	01150	6010000	5,921,221	3,931,257	1,989,964	66
001	87	1087016	01	01150	6020000	6,600,000	4,777,618	1,822,382	72
001	87	1087016	01	01150	6060000	50,000	50,000	-	100
TOTALI						50,671,221	32,783,906	17,887,315	65

Një paraqitje grafike e realizimit të treguesve sipas artikujve jepet në grafikun më poshtë:

Grafiku nr. 1



Referuar pasqyrës nr. 1, realizimi i fondeve buxhetore për shpenzimet korente për vitin 2018 është në masën 65%, në raport me fondet buxhetore të ndryshuara për vitin 2018. Faktorët që kanë ndikuar në këtë mosrealizim janë të analizuar si më poshtë vijon:

Në artikullin 600 & 601 “Fondi i pagave dhe Sigurimeve shoqërore & shëndetësore” fondet janë realizuar, respektivisht nga 63% dhe 66% e buxhetit vjetor të ndryshuar.

Diferenca prej 33% të parealizuara për vitin 2018 është krijuar pasi me Aktin Normativ nr.1, datë 26.7.2018 për “Disa ndryshime në ligjin nr.109/2017 për buxhetin e vitit 2018”, është akorduar për institucionin tonë fondi i pagave shtesë prej 12,500 mijë lekë dhe për shpenzime operative 2,500 mijë lekë ndërsa numri i punonjësve parashikohet të jetë 82, me qëllim funksionimin e plotë të AMBU-së, duke ditur se struktura ende nuk është plotësuar dhe fondi i pagave nuk është përdorur.

Në artikullin 602 “Shpenzime Operative” ku buxheti i ndryshuar vjetor është 6,600 mijë lekë, janë realizuar 4,778 mije lekë ose në masën 72% në raport me totalin. Mos realizimi në këtë rast vjen si pasojë e faktit të mos funksionimit me kapacitet të plotë të institucionit për arsye të vendeve vakante.

II. INVESTIMET

KRYEMINISTRIA
AGJENCIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE UJORE

Pasqyra Nr.2

SHPENZIMET FAKTIKE NE NIVEL ARTIKULLI PER PERIUDHEN JANAR- DHJETOR 2018

Lekë

Entiteti	Ministria e Linjes	Kodi Institucionit	Kapitulli	Programi	Logaria Ekonomike	Kodi Thesarit	Buxheti vjetor	Shpenzimet Faktike per Janar-Dhjetor 2018	Diferenca (11-10)	% realizimit (11/10*100)
1	2	3	4	5	6	7	8		12	13
001	87	1087016	01	01150	230,000	3,535	10,000,000	-	10,000,000	0
							10,000,000	0	10,000,000	0

Referuar pasqyrës nr. 2, realizimi i fondeve buxhetore për shpenzimet kapitale për vitin 2018, është në masën 0% e fondit të planifikuar, pasi për projektin me kod M 870057 “Studim fizibiliteti për përcaktimin e fushave të kërkimit shkencor për burimet ujore dhe menaxhimin e

risqeve” me fondin limit 10,000 mijë lekë për vitin 2018, nuk u arrit të realizohej procedura e prokurimit.

II. Objektivat për vitin 2018

1. Ndërtimi i një sistemi total të integruar për drejtimin dhe menaxhimin efektiv të burimeve ujore;
2. Ndërtimi i një sistemi të integruar të informacionit në fushën e ujit;
3. Mirëmanaxhimi kombëtar i burimeve ujore;
4. Mirëadministrimi dhe mbrojtja e ujrave ndërkufitare;
5. Optimizimi i vendimarrjeve të KKKU-së për përdorimin e burimeve ujore;
6. Mirëfunksionimi i Këshillave të Baseneve Ujore;
7. Ndërtimi i një sistemi të integruar të menaxhimit të burimeve njerëzore, financiare dhe asetëve, si pjesë e sistemit total të integruar të qeverisjes dhe menaxhimit të burimeve ujore;

Realizimi i objektivave nënkupton realizimin e aktiviteteve dhe produkteve, të pasqyruara në PBA për vitin buxhetor 2018.

Në funksion të realizimit të objektivave janë kryer aktivitetet dhe realizuar produktet si më poshtë vijon:

Produkti A: *Implementimi i Programi Kombëtar Sektorial nepermjet zbatimit te planit te veprimit – realizuar në masën 60 %*

Programi Kombëtar Sektorial konsiderohet i finalizuar nga pikepamja teknike dhe permbajtja pasi ka kaluar në të gjitha fazat e konsultimit me institucionet kryesore, aktorët lokalë dhe donatorët. Është përgatitur një broshurë përmbledhëse në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze për të rritur më shumë kuptueshmërinë, nga institucionet e tjera dhe donatorët. Aktualisht pritet vetëm vendimmarrja nga KKKU ku është përcjell për mendim nga ministritë e linjës, dhe më pas do të kalojë për miratim në Këshillin e Ministrave, së bashku me Planin e Veprimit. Kjo për arsye se disa nga ministritë e linjës kanë ndryshuar emërtimet dhe kompetencat. Megjithatë disa nga masat e evidentuara për burimet ujore po ndiqen nga AMBU, ku mund të përmendet draftimi i VKM-së për ujrën nëntokësore, dhe ndjekja e aksionit për shfrytëzimin e lumenjeve, përfshirë edhe masat e tjera që po ndiqen dhe zbatohen nga institucionet përkatëse. Megjithëse programi nuk është miratuar ende, nga ky i fundit janë ekstraktuar nevojat për mbrojtjen nga përmbajtjet, në bazë të të cilave po aplikohet për financime nga WBIF. Nga AMBU është përshtatur drafti i PKS-së me ndryshimet e emërtimeve të ministrive përkatëse dhe mbetet vetëm vendim marrja politike për miratimin e tij. Nga Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri është ndërmarrë një nismë për rikonfigurimin e GMIP-së, e cila është konkretizuar me Urdhrin e Kryeministrit Nr.157, datë.22.10.2018, “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si edhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”. Në zbatim të këtij urdhri dhe duke pasur në

konsideratë punën e bërë deri tani për finalizimin e PKS-së nga AMBU janë marë të gjitha masat për zbatimin e kësaj qasjeje.

Produkti B: Ndjekja e mbledhjeve të Nëngrupeve Tematike – **realizuar në masën 0 %**

Gjatë kësaj periudhe nuk është zhvilluar asnjë mbledhje e GMIP-së për arsye të rikonfigurimit të ministrive, strukturës së KM dhe AMBU që luan rrolin e sekretariatit të GMIP-së. Megjithatë drafti final i PKS është percejllë strukturave përkatëse në KM dhe anëtarëve të KKU-së, në rolin e GMIP-së, për të marë dakortësinë politike dhe më pas të miratohet me VKM. Rezultate dhe konkluzionet e punës së nëngrupeve tematike në PKS janë bërë pjesë e përgatitjes së Raportit Vullnetar Kombëtar për arritjen e Objektivave Zhvillimore të Qëndrueshëm të Kombeve të bashkuara që do të mbahet në New York. Për këtë të fundit nuk ka ende një vendim marrje politike. Në zbatim të urdherit të ri të KM është hartuar kalendari i takimeve të grupeve të reja tematike për vitin 2019.

Produkti C: *Ecuria e punës së nëngrupeve tematike dhe organizimi i mbledhjeve të Grupit për Menaxhimin e Integruar të Politikave për Ujin (GMIP) – realizuar në masën 10 %*

Gjatë kësaj periudhe nuk është zhvilluar mbledhje e GMIP për arsye të rikonfigurimit të ministrive, strukturës së KM dhe AMBU-së që luan rrolin e sekretariatit të GMIP-së. Megjithatë drafti final i PKS është percejll strukturave përkatëse në KM dhe anëtarëve të KKU-së, në rolin e GMIP-së, për të marë dakortësinë politike dhe më pas të miratohet me VKM. Rezultatet dhe konkluzionet e punës së nëngrupeve tematike në PKS janë bërë pjesë e përgatitjes së Raportit Vullnetar Kombëtar për arritjen e Objektivave Zhvillimore të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara që u mbajt në New York. Në funksion të monitorimit të këtij procesi nga KM është organizuar një strukturë monitorimi, ku për përcaktimin e indikatorëve ka kontribuar edhe AMBU.

Produkti D: Projekte në ndihmë të institucioneve që merren me menaxhimin e ujit – **realizuar në masën 10 %.**

Aktualisht AMBU është në fazë ristrukturimi. Me hyrjen në fuqi të Ligj nr. 6/2018 që amendon Ligjin nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore” është krijuar Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore. Ndërkohë ka hyrë në fuqi VKM nr. 221 datë 26.4.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e AMBU-së”. Procedurat për realizimin e këtyre projekteve do të nisnin menjëherë pas formalizimit, përcaktimit të detyrave të reja të kësaj strukture dhe plotësimit final me staf. Në lidhje me projektin është kontraktuar një konsulent për hartimin e termave të referencës. Janë duke u ngritur grupet e punës për fillimin e procedurës së tenderimit të konsulencës teknike. Realizimi 10%. Procedura e prokurimit u shty për në vitin 2019 duke qënë se afatet për finalizimin e procesit nuk mund të përmbylleshin brenda 2018.

Produkti E: Hartimin e standardeve, rregullave dhe përputhshmërinë e informacionit në bashkëpunim me ASIG dhe institucionet e tjera qëndrore dhe vendore – realizuar në masën 100 %

ASIG ka miratuar në BIG standartet për hidrografinë dhe Kadastra Kombëtare për Burimet Ujore ka përcaktuar standartet dhe atributet kryesore në përputhje me INSPIRE direktive. Në këto kushte AMBU është kujdesur duke koordinuar edhe me ASIG që nga çdo projekt të respektohen këto standarde. Pjesëmarrje në takimin rreth programit IPA DRAM dhe PRONEWS (realizimi i hartave të përmbytjeve, organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile. Koordinim me DCG për respektimin e standardeve të ndarjes së trupave ujore (basene/nenbasene)

Produkti F: Ndjekja e Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore dhe hartimi i inventarit të burimeve ujore – realizuar në masën 100%

Në bashkëpunim me SIDA dhe Bankën Botërore do të zhvillohet një projekt për rishikimin e kuadrit ligjor dhe institucional, standardeve dhe procedurave për rrjetin e monitorimit të burimeve ujore. Kjo do të shërbejë si një instrument në funksion të përditësimit sistematik të Kadastrës. Për sa më sipër janë finalizuar ToR's të projektit dhe po ndiqet procesi i kontraktimit të konsulentit. Realizimi 4 takime

Produkti G: Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore (SKMBU) - realizuar në masën 100 %

SKMBU në kapitullin e fundit do të plotësohet me planin e masave i cili duhet të ndiqet dhe të zbatohet nga institucionet përgjegjëse. AMBU ka për detyrë kontrollin e zbatimit të masave të miratuara.

Produkti H: *Ndjekja e procesit të hartimit, miratimit dhe zbatimit i Planeve të Menaxhimit të Baseneve Drin-Bunë dhe Seman – realizuar në masën 90 %*

Referuar ligjit 111/2012 "Për menaxhimin e Burimeve Ujore", i ndryshuar duhet të miartohet në KKU dhe më pas kalon për miratim në KM. I gjithë ky proces do të ndiqet nga AMBU, që të reflektohen komentet e institucioneve përgjegjëse dhe të miratohet dokumenti final.

Eshtë paraqitur drafti përfundimtar.

Produkti I: *Ndjekja dhe mbikqyrja e hartimit të Planit të Menaxhimit të Basenit (PMB) Shkumbin – realizuar në masën 50 %*

Takimet me konsulentin për të shkëmbyer informacionin e nevojshëm dhe për të kontrolluar ecurinë e procesit. Analizimi tekniko ligjor i dokumentacionit të dorëzuar nga konsulenti (referuar kontratës). Pjesëmarrja e stafit në trajnimet dhe workshopet e organizuara në kuadër të hartimit të PMB-së Shkumbin.

Produkti J: *Nxitja e procesit për hartimin e VKM për zonat e veçanta ruajtjes – realizuar në masën 0 %*

Organizimi i takimeve të përbashkëta për çdo basen me aktorët kryesor, për përcaktimin e zonave të ruajtjes për basenet Mat, Ishëm-Erzen, Shkumbin, Vjosë. Në zbatim të nenit 60, të ligjit 111/2012 (i ndryshuar).

Produkti K: *Ndjekja e procesit të mardhënies me vendet fqinje për mirëadministrimin e ujërave ndërkufitare – realizuar në masën 40 %*

Si pjesë e KPAUN, është kontributi tekniko-ligjor lidhur me çështjet që ky komision shqyrton. Shkëmbim informacioni për ujrat ndërkufitare lidhur me projektet që ndërmerren nga vendi ynë dhe shtetet fqinjë.

Produkti L: *Organizimi i mbledhjeve të Këshillit Kombëtar të Ujit (KKU) dhe zbatimi i detyrave të lëna nga ky organ – realizuar në masën 80 %*

Kontrolle në terren lidhur me lejet e dhëna nga KKU ose ato që janë në proces. Analizimi i dokumentacionit tekniko-ligjor dhe propozimi për miratim KKU-së, bën oponencën e dokumentave që paraqiten për vendimmarrje.

Produkti M: *Kontroll i veprimtarisë të organeve vendore të Menaxhimit të Burimeve Ujore – realizuar në masën 100 %.*

Ndjekja dhe kontrolli i punës së organeve vendore të menaxhimit të burimeve ujore si dhe procedurat e dhënies dhe zbatimit të lejeve dhe autorizimeve. Referuar ligjit 111/2012, neni 12, pika 2 e tij AMBU, asiston KBU-të për kryerjen sa më mirë të detyrave që ju ngarkon ky ligj.

Produkti N: *Ndekja dhe koordinimi i sistemit të integruar të menaxhimit të burimeve financiare – realizuar në masën 70 %*

Korrespondenca me ministritë e linjës, KM dhe institucionet e tjera me qëllim marrjen e plotë të informacionit të përditësuar lidhur me buxhetin e PKS – së sipas secilit objektiv dhe produkt.

Produkti O: *Modelimi i sistemit të integruar të menaxhimit të burimeve njerëzore – realizuar në masën 70%*

Takime me përfaqësues të institucioneve që lidhen me sektorin e ujit nëpërmjet organizimit të takimeve me stafin e KBU dhe ABU. Gjithashtu është marrë gjithë informacioni lidhur me mundësinë e pjesëmarrjes së stafit në trajnimet e zhvilluara nga ASPA si dhe është marrë dhe përditësuar i gjithë informacioni lidhur me ABU-të.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

GERTA LUBONJA